

**PROGRAMI I LËNDËS “E DREJTA PUBLIKE EKONOMIKE / E DREJTA DHE POLITIKA
EVROPIANE E ENERGJISË”
VITI AKADEMIK 2013 - 2014**

Fakulteti: Juridik/Shkenca Politike/Ekonomike/Inxhinierike

Reference ne Anglisht: Economic Public Law / EU Energy Law and Policy

Niveli: Bachelor dhe Master

Kreditet 6 (4 + 2) ECTS

Orë mësimi: Në auditor 60 (45 + 15)

Semestri: I-të ose i II-të, i Vitit II-të ose i III-të.

Lënda: E detyrueshme ose me zgjedhje.

Gjuha: Sipas kërkesës ne Shqip, Anglisht, Italisht ose tjetër.

Përshkrimi i Lëndës

Lënda do të ketë për objekt gjithëpërfshirës rregullimin e tregut energjetikë në perspektivën e integritimit evropian. Aktualisht, reforma që ka përfshirë sektorin energjetikë, korrespondon me angazhimin për krijimin e një tregu të energjisë plotësisht të hapur dhe ndërlidhur nëpërmjet dinamikave konkurrenente. Proces që tanimë përbën realitetin në nivele rajonal duke u shoqëruar me eliminimin e të gjitha barrierave si dhe operimin me mekanizma të njësuar në të gjitha tregjet energjetikë nën parashikimin e integritimit të plotë ndërrajonalë nga fillim viti i 2014 për vendet e BE-së dhe i 2015 për Shqipërinë në kuadër të ENCT.

Evoluim që bënë të domosdoshme dhe njëkohësisht të pashmangshme nevojën për njohje dhe të kuptuar të tregjeve të rregulluar dhe operimin nëpërmjet profileve telemaktike për shfrytëzim e plotë nëpërmjet një qasje tekniko-normative ndërdisiplinore me vokacion të aplikuar. Në mbështetje të filozofisë mbi avantazhet e konkurrueshmërisë së tregut dhe nevojën për studime dhe profilizime mësimdhënëse të avancuar, kjo lënde vjen si pikënisja e përbashkët për aktivizimin e interesit akademike në shërbimin publike në përputhje me të gjithëpranishmin interes për rritje dhe zhvillim ekonomikë të konsoliduar e të qëndrueshëm.

Objektivat

Për sa më sipër dhe në përputhje me *target-in* e përgjithshëm të këtij kursi për të ndihmuar të kuptuarin e funksionimit të tregjeve të liberalizuar dhe mekanizmave të posaçëm që drejtojnë “tregjet e rregulluara” ku bënë pjese dhe ai energjetikë:

- Për një kuadër të thelluar do të niset me përshkrimin historik të formave të ndryshme të ndërhyrjes publike në ekonomi. Më tej kujdes i veçantë do t’i kushtohet rolit të institucioneve dhe normativës komunitare dhe rregullimit ligjore pas viteve ‘90, përmes tre ndërhyrjeve me të cilat merre zhvillim liberalizimi progresive i sektorit energjetikë drejt inkuadrimin në një treg plotësisht konkurrenente.
- Në këtë kuadër, objektin specifike i lëndës do te përbëhet nga disiplina dhe instrumentet e nevojshëm që lejojnë të kuptuarin e impakteve të proceseve integruese në sektorin energjetikë

Shqiptarë. Objektivë që arrihet duke sintetizuar në një strukturë të evoluar kuadrin kompleks dhe karakteristikat heterogjene që ndërveprojnë nëpërmjet krahasimit të dy modeleve klasike *par excellence* siç është ai Britanik kundrejt atij të Evropës Veriore, si dhe ndikimin efektiv të *acquis communautaire* në procesin legjislativ të brendshëm nëpërmjet modeleve më tipike të shfaqjes si p.sh. ai në kuadrin normative italiane, përveçse studimit të tendencave konvergjente harmonizuese në zhvillim në disa nga vendet më përfaqësues të BE-së dhe zhvillimet e njëkohshme të pjesëmarrësve në të ashtuquajturin tregun e 8-të rajonal ose ENC SEE.

- Në këtë kuadër tiparet më përcaktuese të liberalizimit të kontekstit shqiptarë që analizohen në veçanti në mënyre të thelluar janë shkalla e *unbundling*, niveli i hapjes së siguruar ndërmjet së drejtës për hyrje në rrjet të palëve të treta (TPA) dhe njohjen e statusit të konsumatorëve të kualifikuar si dhe të drejtës për *switching*, menaxhimin e kongjestionëve dhe alokimin e kapaciteteve, funksionet dhe pavarësia e NRA-ve, zbatimi i detyrimeve të shërbimit publik, shkalla e zhvillimit të tregut të brendshëm si dhe integrimi në nismat mbi tregjet e përbashkët rajonale dhe prospektiva që ofrohet në kuadër të projektit NWE DA.

- Ndërtim që mundëson formimin e një opinioni të mirë argumentuar mbi problemet më të fundit që kanë shënuar sektorin energjetikë Shqiptarë. Njohje që konsiderohet e qenësishme për shfrytëzimin e të gjitha kapaciteteve të tregut si dhe për plotësimin e mëtejshëm të vetë procesit integruar të BE-së. Profile që bëjnë të nevojshëm përmbylljen me përvetësimin e instrumenteve aktuale të operimit në bursat energjetike dhe ato të shërbimeve financiare, duke përcjelle dhe aftësimin për të kuptuar principet e operimit në kuadër të procesit të liberalizimit dhe mbështetjen e hyrjes së aktoreve të ri në me shtrirje të njëkohshëm në nivele kombëtarë e rajonal si dhe më gjerë në të gjithë BE-në.

- Pikëmbërritje e cila ndihmon për të sintetizuar në mënyre gjithëpërfshirëse të kuptuarin e një reformë objektivistike komplekse dhe në mënyrë të pashmangshme subjekt të rimodelimeve me impaktë jo pak të rëndësishëm ekonomik, sidomos për vendet pa traditë të gjatë në *governance* institucionale dhe financiare (siç dëshmohet nga përvoja falimentare e ČEZ në Shqipëri), si dhe nevojën urgjente të një përqasje me strategji të integruar dhe të modular të “trazitimit” nga një treg i përqendruar monopolist në atë të rregulluar me dinamika konkurrenciale të efektshme.

Për sa më sipër, programi i mësimdhënies do të ndërtohet me leksione frontale, seminare e diskutime të cila nuk përsërisin thjeshtë të parat por synojnë të pasurojnë atë me shembuj të marrë nga realiteti shqiptarë, ai i vendeve direkt të interesit ose ato që shënojnë tendencat më të fundit në kuadrin Evropian. Për këtë gjatë zhvillimit të kursit, aktiviteti didaktik do të pasurohet me ndërthurje eksperiencash që do vijnë nga pjesëmarrja e eksperteve kombëtarë dhe ndërkombëtarë të fushës së drejtës publike ekonomike, asaj rregullatore dhe në veçanti energjetike.

Java	Përmbajtja e Lëndës
1	MENAXHIMI I RESURSEVE ENERGETIKE NË KONTEKSTET KOMBËTARE

	<p>Tema I – Inkuadrimi teorik i kuadrit të parareformës së sektorit energjetikë.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Inkuadrimi teorik i së drejtës publike ekonomike. 2. Fillesat e organizimit të sektorit energjetike në Evropë. 3. Profili historik i zhvillimit të ndërhyrjes publike në shërbimet energjetikë. 4. Ndërtimi i kuadrit të shërbimeve publike energjetikë dhe i tregjeve të rregulluara. 5. Inkuadrimi i sektorit energjetikë si një shërbim publik. 6. Perspektivat e aplikimeve në praktike të pronësisë publike dhe shtetëzimeve. 7. Specifikat e nacionalizimit të sektorit energjetik në Evropën perëndimore dhe lindore.
2	<p>FILLESAT E LIBERALIZIMIT TË TREGJEVE KOMBËTARE</p> <p>Tema II - Principet themelore në traktatet e komuniteti evropian</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Faza e parë e avancimit dhe miratimi në mënyrë derivate të rregullave specifike. 2. Konceptimi i energjisë elektrike si mall dhe shërbim. 3. Instaurimi i periudhës së dytë dhe “nënshtrimin” ndaj rregullave të konkurrencës për kategoritë e shërbimeve të interesit të përgjithshëm ekonomik. <p>Tema III - Shfaqja e formave të liberalizimit të sektorit energjetikë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fillesat në vendet e Amerikës Latine dhe shtetet e ndryshme të SHBA-së. 2. Format e hershme në Britaninë e Madhe dhe në vendet e para evropiane. 3. Analiza teorike e perceptimit të monopoleve natyrore. 4. Vëmendja në rritje e organeve komunitare përgjatë viteve 1980-90. 5. Dy direktivat e ‘90 për transparencën e çmimeve dhe mundësinë e tranzitimit në rrjetet ndërkombëtare.
3	<p>Tema IV - Transformimet e paradigmës së ndërhyrje publike në sektorin energjetike</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Modeli i shoqërive tregtare me kapital publik. 2. Arsyet e domosdoshmërisë së pjesëmarrjes private. 3. Teoritë rregullatore të kalimit nga shteti monopolist në shtetin rregullatorë si dhe krahasimi i modeleve. 4. Koncepti i kompanive vertikalisht të integruar. 5. Krijimi i autoriteteve administrative të pavarura dhe karakteristikat e tyre. 6. Konkurrenca në gjenerim, në tregtimin me shumicë dhe atë me pakicë. 7. Principet e <i>price cap</i> në sistemin monopolistë.
4	<p>MIRATIMI I PAKETËS SË PARË TË ENERGJISË SË BE-së</p> <p>Tema V - Adoptimi i direktivave 96/92/CE dhe 98/30/CE.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Afirmimi i paradigmës mbi konkurrencën në marrëdhëniet ekonomike dhe menaxhimin e shërbimeve publike. 2. Ndarja kontabël e menaxhimit dhe e infrastrukturës nga prodhimi dhe furnizimi. 3. Njohja e së drejtës së hyrjes në rrjetit të palëve të treta. 4. Forcimi i pavarësisë së autoriteteve administrative. 5. Hapja e tregut me shumicë dhe e furnizimit të lirë për konsumatorët e mëdhenj. <p>Tema VI - Eksperiencat e para të liberalizimit.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Eksperiencat që i paraprinë miratimit të paketës së parë të energjisë: modeli angleze,

	<p>norvegjezë.</p> <p>2. Modeli i njëkohshëm spanjollë.</p> <p>3. Implementimi në kuadrin normative italian të paktës së parë: adoptimi i dekreti Bersani 79/1999 dhe dekreti Letta 164/2000.</p> <p>4. Kalimi përtej kufirit minimale të planifikuar nga ndërhyrjet e BE-së.</p> <p>5. Hapja drejt kapitaleve private në “kolosët publike”.</p>
5	<p>Tema VII – Problemet e lidhura me rregullimet e sektorët strategjike.</p> <p>1. Fenomeni i ndërhyrjes ligjore, liberalizimet dhe privatizimet.</p> <p>2. Disiplina e konkurrencës eficientë të tregut.</p> <p>3. Tregjet jo kompletë, informacion asimetrik, kriza dhe ciklet ekonomike, fenomeni i falimentimeve të tregjeve.</p> <p>4. Sektori publik në një ekonomi mikse dhe shërbimet e rëndësisë strategjike.</p> <p>5. Disiplina speciale e sektorëve të veçante: nga ato me shtrirje lokale në ato kombëtare.</p> <p>6. Paradigma e shërbimeve universale.</p> <p>7. Disiplina e përgjithshme e ndalimit të përqendrimeve, marrëveshjeve dhe abuzimit me pozicionin dominues.</p> <p>8. Politikat komunitare në mbrojtje të konsumatorëve.</p>
6	<p>KORNIZA E KUADRIT TE REFORMUAR NË SHQIPËRI</p> <p>Tema VIII – Transformimet politike dhe institucionale në Shqipëri.</p> <p>1. Përshkrim mbi kuadrin e së drejtës publike ekonomike.</p> <p>2. Transformimet e thella të sektorit energjetik shqiptarë: nevoja për liberalizim dhe fillimi i tkurrjes së sektorit publik nga profilet e kuadrin energjetikë si dhe mundësitë që krijohen nga bashkëpunimi ndërinstitutionale.</p> <p>3. Memorandumi i Mirëkuptimit të Athinës 2002, për integrimin e sektorit energjetik shqiptarë në tregun rajonalë të energjisë të Evropës Jug-Lindore.</p> <p>4. Sinkronizimi me rrjetin UCTE.</p> <p>Tema IX – Miratimi i kuadrit të ri normativ më 2003.</p> <p>1. Ligji për sektorin e energjisë elektrike dhe strategjia kombëtare.</p> <p>2. Projektimi drejt një zhvillim të plotë të një tregu konkurrues.</p> <p>3. Proceset integruese evropiane dhe zbatimi i <i>acquis</i> në legjislacionin kombëtar.</p> <p>4. Liberalizimi dhe profilet e strukturuar të tregut me shumicë dhe pakicë.</p> <p>5. Integrimi në iniciativat rajonale.</p> <p>6. Mekanizmat e vendosjes së çmimeve dhe tarifave (në konsideratë të cilësisë së shërbimit).</p> <p>7. Plotësimi i integritetit të tregjeve (ndërlidhja) ndërmjet vendeve fqinje.</p>
7	<p>MIRATIMI I PAKETËS SË DYTE TË ENERGJISË SË BE-SË</p> <p>Tema X – Miratim i paketës së dytë të energjisë në nivel evropian.</p> <p>1. Direktiva 2003/54/CE dhe Direktiva 2003/55/CE.</p> <p>2. Rregulloret mbi tranzitimin si objektive thelbësore të liberalizimit të sektorit.</p> <p>3. Hapja e plotë e tregut nga ana e kërkesës për të dy sektorët: fillimi me konsumatorët</p>

	<p>industriale nga 1° korrik 2004.</p> <p>4. Kompletimi për të gjithë konsumatorët nga 1 korrik 2007.</p> <p>Tema XI – Vijimi i reformave për Shqipërinë.</p> <p>1. Nënshkrimi i Traktatit 2006/500/CE dhe angazhimi për adoptimin e <i>acquis</i> evropiane për energjinë.</p> <p>2. Liberalizimi i tregut të energjisë për konsumatorët e mëdhenj nga 2008 dhe hapja e plotë për të gjithë konsumatorët deri në vitin 2015.</p> <p>3. Ligji 9946/2008 për sektorin e gazit natyror.</p> <p>4. Masat e tjera të interesit në implementim e Ligji 9072/2003.</p> <p>5. VKM e 19 mars 2008 n. 338 mbi modelin e tregut elektrik në Shqipëri.</p>
8	<p>MIRATIMI I PAKETËS SË TRETË TË ENERGJISË SË BE</p> <p>Tema XII – Hyrja në fuqi e paketës së tretë.</p> <p>1. Ndërhyrja për të korrigjuar praktikat në kundërshtim me tregun (19 shtator 2007).</p> <p>2. Marrëveshja politike në Këshillin e janarit të 2009 për hyrjen në fuqi të paketës së tretë.</p> <p>3. Përmbajta e dy Direktivave dhe tre Rregulloreve.</p> <p>4. Mundësia midis modeleve për rrjetet e transmetimit për shtetet anëtare.</p> <p>Tema XIII – Afati i implementimit të plotë të tregut të integruar.</p> <p>1. Vendimi i Këshillit Evropian të 4 shkurtit 2011 për realizimit e plotë të tregut të brendshëm deri në vitin 2014.</p> <p>2. Marrja e angazhimit të ENCT për adoptimin brenda vitit 2015 të Paketës së tretë për energjinë të BE-së.</p> <p>3. Përmbajta e vendimit të 6 Tetor 2011 për Shqipërinë në kuadër të ENCT.</p> <p>4. Zhvillimet e interesit në vendet anëtare të tregut rajonale të 8-të.</p>
9	<p>PROCEDIMI DREJT FORMIMIT TE TREGUT TE INTEGRUAR ENERGJETIKË</p> <p>Tema XIV – Masat e implementimit të <i>acquis</i> lidhur me hapjen e plotë të tregut.</p> <p>1. Instaurimi i zyrës për zhvillimet e ankandëve të përbashkët në Evropën Jug-Lindore (SEE CAO).</p> <p>2. Përpjekjet në sektorin e gazit: përgatitja e kuadrit ligjor që lidhet me projektin Tap dhe Unazën e Gazit.</p> <p>3. Intensifikimi i burime të brendshme me ndërtimin e HEC të reja dhe centraleve eolike me anë të formulave koncesionare.</p> <p>4. Interesi i shprehur nga investitorët e huaj edhe shkaqet e zvarritjeve të projekteve.</p> <p>5. Rritje e kapaciteteve në transportin e tensionit të lartë.</p>
10	<p>INSTRUMENTET E OPERIMIT TE TREGUT TE INTEGRUAR</p> <p>Tema XV – Funkionimi i bursës energjetike.</p> <p>1. Modelet e bursave të energjisë: <i>market pool</i> dhe <i>power exchange</i>.</p> <p>2. Hyrja në funksion sipas meritës ose koston margjinale. Zgjedhja e kohës së prodhimit.</p> <p>3. Limitet që rrjedhin nga rrjetet. Llogaritjet për çmimet <i>spot</i> ose modulare.</p> <p>4. Tregu i kontratave <i>Forward</i> (bilaterale, OTC), tregu i ditës përpara, tregu ndër-ditor, tregu i axhustimeve, tregu i shërbimeve të dispeçerimit (rezervës, modulimit, etj.), tregu i</p>

	<p>kapaciteteve, tregu i produkteve financiare, derivate.</p> <p>5. Shfaqja e platformave të konti energjisë për burimet e rinovueshme.</p> <p>Tema XVI – Forma e organizimit për tregun shqiptarë të energjisë.</p> <p>1. Inkuadrimi në modelin rajonal të ENCT.</p> <p>2. Interesi për formë teorike ose transitore.</p> <p>3. Modeli definitive në projektim <i>Europe-wide single price coupling</i>.</p> <p>4. Zgjidhja e PCR për integrimin të plotë në një treg të vetëm.</p> <p>5. Modeli target i BE-në për shkëmbim në Capacity Allocation and Congestion Management - CACM.</p> <p>6. <i>Market Coupling</i> me dhe pa kapacitete interkoneksioni (roli i ENTSO-VE).</p>
11	<p>PROFILIT TË REJA SPECIFIKE TË OPERIMIT</p> <p>Tema XVII – Përcaktimi konkurrent i çmimeve.</p> <p>1. Konceptimi historik i çmimeve në teori.</p> <p>2. Elasticiteti i kërkesës. <i>Peak</i> dhe <i>off peak pricing</i>.</p> <p>3. Çmimi margjinalë dhe çmimi mesatar.</p> <p>4. Investimet mbi kërkesën. Barrierat e çmimeve eficiente.</p> <p>5. Pagesat në tregjet <i>pool</i>, sipas <i>Market clearing price</i> - MCP dhe <i>Pay as Bid</i> - PaB.</p> <p>6. Tipologjitë e gjenerimit: optimizmi. Dominimi në treg. Çmimet e tregut.</p> <p>7. Kosto <i>implicit</i> dhe ato të rezervës. Ekuilibri i tregut.</p> <p>8. Rasti i centraleve hidroelektrike: strategjia e çmimeve.</p> <p>Tema XVIII – Kostot e përgjithshme të sistemit.</p> <p>1. Konflikti i incentivëve.</p> <p>2. Roli dhe efekti i humbjeve. Studim i rasti Cez.</p> <p>3. Zgjedhja optimale e investimeve. Kthimi i investimeve në praktike.</p> <p>4. Operatorët e rinj në tregun energjetikë dhe atë të gazit. Kriteret për zgjedhjen e furnizuesit.</p> <p>5. Klientët në tregun e lirë. Përbërja e zërave të faturës.</p> <p>6. Produktet financiarë të tregut energjetikë: kontratat fizike dhe kontrata e diferencave.</p> <p>7. Kontratat <i>swap</i>, <i>vanilla swap</i>, <i>caps</i> e <i>floors</i>.</p>
12	<p>SFIDAT DREJT TREGUT ENERGETIKË TE INTEGRUAR</p> <p>Tema XIX – Nevoja ndërtimit të kushte paraprake të konkurrencës.</p> <p>1. Funkcionimi i tregut kombëtare në një mjedis konkurrues.</p> <p>2. Ndërveprimi në një treg të integruar nën-rajonale apo rajonale.</p> <p>3. Kalimi në tregun e integruar evropianë.</p> <p>4. Integrimi dhe kalimi për anëtarët ENCT nga marrëveshjet dypalëshe në ankandet eksplicite në sistemin e ankandeve <i>implicit</i>.</p> <p>Hapjen e plotë e tregut të brendshëm deri në vitin 2015.</p> <p>Tema XX – Modeli EU CACM.</p> <p>1. Mekanizmi që lidhet me rrjetet e transportit dhe alokimin e kapaciteteve të menaxhimit të mbivendosjeve.</p>

	<p>2. Kosto për kongestionet.</p> <p>3. Konvergimi drejt një modeli të bashkërenduar për kompletimin e tregut të brendshëm.</p> <p>4. Operimi nga qershor 2013 të SEE CAO, për koordinimin e ankandëve për EJK.</p> <p>5. Roli i linja të transmetimit dhe përcaktimet e te ardhurave financiare (rentës).</p> <p>6. Opsionet mbi investimet dhe marrja e vendimeve.</p>
13	<p>Tema XXI – Zhvillimet e ardhshëm në tregun e 8-të.</p> <p>1. Platforma e detyrimit për çdo treg kombëtar (edhe Shqipërinë) në kuadër të ENCT.</p> <p>2. Angazhimet për të përmbyllur implementimin e legjislacionit të BE-së brenda vitit 2015.</p> <p>3. Periudha deri më 31 dhjetor 2012: nevoja për njohje (ose përmisime të përkufizimit) të statusit të klientit të kualifikuar dhe metodologjitë për llogaritjen e tarifave.</p> <p>Tema XXII – Raundi i masave brenda 31 korrik 2013.</p> <p>1. Nxjerrja jashtë kuadrit të çmimeve të rregulluara të gjithë konsumatorëve të kualifikuar.</p> <p>2. Pasqyrimi dhe përfshirja e të gjitha shpenzimeve në tarifën finale.</p> <p>3. Ndërtimi i një kuadri mbi konsumatorët në nevoje (që parashikon zhvendosjen e skemës së ndihmës nga sektori i energjisë në sistemin kombëtar të asistencës sociale).</p> <p>4. Zëvendësimi i kontratat të furnizimit me ngarkesë të plotë me kontratat bazë, dhe reduktimi i vëllimeve nga viti në vit.</p> <p>5. E drejta e ish-<i>incumbent</i>-it publike dhe çdo prodhuesi për të shitur energjinë e tepërt (ose te programuar) në tregun kombëtare dhe atë rajonale.</p> <p>6. Implementimi me përfshirjen në tregun afat-shkurtër.</p> <p>Tema XXIII – Krijimi i likuiditetin për tregun DAM.</p> <p>1. Krijimit i një tregu rajonalë të energjisë nisur nga përmasat e vogla të tregut të brendshëm.</p> <p>2. Krahasimi me modelet e testuar në shtatë tregjet e energjisë.</p> <p>3. Preferenca për qasjen e decentralizuar që gjendet aktualisht tek modeli CWE dhe atë GB.</p> <p>4. Përqasjen operative bazë të projektit <i>Europe-wide single price coupling</i> për vendet anëtare të EnCT.</p>
14	<p>VLERËSIME PËRMBYLLËSE NE LIDHJE ME KUADRIN E RI</p> <p>Tema XXIV – Avantazhet e tregut të integruar</p> <p>1. Rritje e konkurrencës, transparencës, sigurisë, zhvillimit teknologjikë, kujdesit për ambientin, e në kompleks një zhvillim i qëndrueshëm.</p> <p>2. Incentivët dhe certifikate jeshile. Ndryshimet në mekanizmat ndihmëse.</p> <p>3. Certifikatat e bardha dhe masat për eficiencë.</p> <p>4. Normativa evropiane dhe shqiptare mbi reduktimin e konsumit.</p> <p>5. Tregu i TTE. Protokoli i Kyotos dhe mekanizmat fleksibël.</p> <p>6. Segmentet e tregut të karbonit dhe plani i masave të Shqipërisë.</p> <p>7. Tregu i organizuar i certifikatave.</p> <p>8. Etapat e mirë caktuara të kalimit. Skenarët energjetikë për 2020, 2030 dhe 2050.</p> <p>Tema XXV – Inkuadrimi i përgjithshëm përmbyllës.</p> <p>1. Nevoja e zhvillimit të një strategjie të integruar planifikuese.</p>

2. Përthithja e mekanizmave analitik fleksibël të referencës.
3. Proceset e vendimmarrjes operative.
4. Realizimi i plotë i paradigmës së efikasitetit konkurrent.
5. Krijimi i një *trait d'union* bashkëveprues të *commodity view* me detyrimet e shërbimit publik në përputhje me interesin e përgjithshëm ekonomik.

Literatura

Literatura bazë e detyrueshme:

- (i) Shënimet e marra gjatë leksioneve dhe të vëna në dispozicion në një faqe internet të dedikuar dhe me akses vetëm për qëllime didaktike.
- (ii) Materiale të rekomanduara të vëna në dispozicion në faqen web të dedikuara nga docentit.
- (iii) *Slide-t* të shfaqura dhe të punuara nga docenti.

Literatura e rekomanduar:

- (i) V. Termini, *Energia e istituzioni europее, in l'Unione europea nel XXI secolo*, a cura di S. Micossi e G.L. Tosato, Il Mulino, 2008.
- (ii) G. Pireddu, *Economia dell'energia. I fondamenti*, Pavia University Press 2009.
- (iii) D. Kirschen, G. Strbac, *Fundamentals of power system economics*, John Wiley and sons, 2004.

Rezultate të Arritura në Përfundim të Lëndës

- I. Pajisja e studentëve me një kuptim të plotë të organizimit të tregjeve të integruara dhe në veçanti të atyre të energjisë. Faktor që ndikon në kuptimin e liberalizimi dhe të parimeve ekonomike që qeverisin funksionimin dhe normat që rregullojnë sjelljen e operatorëve në tregjet e avancuar (rregulluara dhe të integruara) telematike dhe virtuale të *comodity* dhe shërbimeve relative financiare. E gjitha do të çojë studentët të kenë bazën teknike juridike, atë të politikave publike dhe ekonomike për analizën e tregut dhe për të kuptuar zhvillimet e tregjeve të energjisë në Shqipëri në kuadër të atij rajonale dhe me gjerë të UE-se.
- II. Përgjatë zhvillimit konkret të kursit do të operohet me objektivat të ndërmjetëm dhe ato finale për të arritur aftësimin e pavarur në përdorimin e instrumenteve themelore për të operuar në rrethanat e reja të tregjeve të integruari siç është ai i energjisë. Rezultante finale e së cilës është transferimi i bagazhit dhe kapacitete ndërdisiplinore të avancuara që aftësojnë të vepruarin në mënyre të pavarur në skenarët dinamik të zhvillimit shumëpalaneshë në nivel kombëtare e më gjerë ndërrajonale dhe të Bashkimi Evropianë.

Metoda e Vlerësimit

Niveli i diskutimit në seminare (20%); Provimi i ndërmjetëm (20%); Detyrë kursi: punë në grup ose ese individuale rreth 2000 fjalë (15%); Provimi përfundimtar (45%).